



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2019:271631

Datë: 07.05.2024

Numri i dokumentit: 05656633

C. nr. 79/2019

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Artan Abazi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit L.M. nga, të cilin me autorizim e përfaqëson Avni Leci, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “SIGAL”, me seli në Prishtinë, rr. “Ukshin Hoti”, nr. 19, Pejton kati 4, të cilën me autorizim e përfaqëson Sokol Dardha, jurist nga Prishtina, me objekt kontesti për kompenzimin e dëmit materiale dhe jomaterial, me vlerë të kontestit prej 47,232.10 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, më datën 13.02.2024 mori, ndërsa më datën 02.05.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësit L. M. nga dhe **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve “Sigal”, me seli në Prishtinë, rr. “Ukshin Hoti”, nr. 19, Pejton kati 4, që në emër të kompenzimit të dëmit material dhe jomaterial, dëme këto të pësuar nga paditësi, në aksidentin e trafikut të shkaktuar me datën 24.08.2009, rreth orës 16:40 minuta, në dalje të fshatit Busavatë, Komuna e Kamenicës – Novobërd, t’ia paguaj paditësit shumat si në vijim dhe atë:

- Në emër të dëmit jomaterial:

Në emër të dhimbjeve fizike-trupore, shumën prej 2.000.00 (dymijë) euro.

Në emër të dhimbjeve shpirtërore për frikën e përjetuar, shumën prej 1.000.00 (njëmijë) euro.

Në emër të dhimbjeve shpirtërore për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësorë për 27.15%, shumën prej 5.000.00 (pesëmijë) euro.

Në emër të dhimbjeve shpirtërore për shëmtimit të shkallës së mesme, shumën prej 2.000.00 (dymijë) euro.

- Në emër të demit material:

Në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj, shumën prej 1.000.00 (njëmijë) euro,

Në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 1.000.00 (njëmijë) euro.

II. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “SIGAL” me seli në Prishtinë, që t’ia paguaj shumat e gjykuara paditësit, respektivisht shumën e përgjithshme prej 12.000.00 (dymbëdhjetëmijë) euro, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të parë, të datës 12.08.2011, e deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 15 ditësh, pas datës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.

III. REFUZHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit L. M. , në shumë prej 35.232.00 euro (tridhjetë e pesëmijë e dyqindë e tridhjetë e dy) euro, shuma këto përtej shumave të gjykuara si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “SIGAL” me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të kompenzimit të demit material dhe jomaterial të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 24.08.2009, rreth orës 16.40 minuta, në dalje të fshatit Busavatë, Komuna e Kamenicës - Novobërdë, t’ia paguaj edhe këto shuma, **SI E PABAZUAR.**

IV. DETYROHET e paditura, që paditësit t’ia paguajnë shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë në shumë të përgjithshme prej 6.363.00 (gjashtëmijë e treqind e gjashtëdhjetë e tre) euro, në afat prej 15 ditësh, pas datës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

1. Rrjedha e procedurës

Paditësi L. M. nga, përmes të autorizuarit të tij Avni Leci, avokat nga Prishtina, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurës të paditurës Kompania e Sigurimeve “SIGAL”, me seli në Prishtinë, rr. “Ukshin Hoti”, nr. 19, Pejton kati 4, të cilën me autorizim e përfaqëson Sokol Dardha, jurist nga Prishtina, me objekt kontesti për kompenzimin e demit materiale dhe jomaterial, me vlerë të kontestit prej 47,232.10 euro.

Lidhur me këtë çështje kontestimore është vendosur paraprakisht sipas Aktgjykimit, C.nr.174/09, të datës 12.08.2011, i cili aktgjykim është prishur sipas Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac.nr.352/2011 të datës 02.07.2012 dhe lënda është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.

Në procedurën e rigjykimit është vendosur sipas Aktgjykimit C.nr.106/2012, të datës 09.07.2014 i cili aktgjykim është prishur sipas Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac.nr.4075/14, të datës 17.05.2019 dhe çështja sërish është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.

Ndërsa, kjo gjykatë në riprocedurë për herë të tretë, duke i pasur parasysh rekomandimet e gjykatës së shakllës së dytë, ka vazhduar me shqyrtimin dhe vlerësimin e fakteve dhe provave relevante dhe ka vendosur si në vijim.

2. Pretendimet e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse

I autorizuari i palës paditëse, avokati Avni Leci nga Prishtina, në seancën përgaditore dhe gjatë seancave të shqyrtimit kryesor, ka deklaruar mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë dhe ka theksuar se nga të gjitha ekspertizat e komunikacionit rrugorë, është konstatuar qartë se i siguruari i të paditurës ka bërë tri lëshime, për shkaktimin e këtij aksidenti dhe atë Shpejtësia më lartë se e lejuar në vendbanim, Pakujdesi gjatë kalimit me automjet në zonen e vendbanimit, reagim me vonës për evitimin e aksidentit në fjalë, ndërsa tek lëshime e këmbësorit, tani paditësit në atë kohë i moshës 8 vjeqare, të gjithë eskeprtizat kanë konstatuar dy lëshime të të njëjtit, dhe atë kalimi i rrugës, pa u siguruar se të njëjtin veprim mund t'a bëjë pa rrezikuar sigurinë në komunikacion rrugor dhe kalimi pas automjetit të ndaluar pa u siguruar se një veprim i tillë rrëzikon sigurinë e komunikacionit. Tutje gjykatës i ka propozuar që sa i përket përgjegjësisë të palëve në aksidentin e shkaktuar, me rastin e gjykimit të kësaj çështje juridike, të merren për bazë, të gjithë faktoret dhe proporcionet e lëshimeve të caktuara nga ekspertet, duke mos i'a falë besimin plotësimin të Super Ekspertizës së UP-së, ngase te njëjtit vetem kanë shënuar tekstin – lëshimet primare dhe sekondare, ndërsa nuk kanë ndryshuar shkaqet dhe lëshimet e përmendura në ekspertizën bazë. Gjithashtu i ka propozuar gjykatës që për këtë çështje juridike paditesit t'i njihet kërkesëpadia që ka të bëjë me 50 % të përgjegjësisë, dhe t'i aprovohet si e bazuar, ndërsa lidhur me lartësin e kërkesëpadisë, për natyrën e lëndimeve dhe pasojat e mbetura te paditësi, t'ia fale besimin ekspertizave mjekësore të administruara nga kjo gjykatë, ndërsa për formën e dëmit jomaterial për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, t'ia falë besimin ekspertizës plotesuese nga lëmia e mjekësisë maksilofaciale, ngase gjendjen faktike eksperti e ka vërtetuar duke e marrë për bazë shërimin – mjekimin e paditësit dhe se eksperti e ka sqaruar gjatë seancës gjyqësore se paditësi nuk ka përmirësuar shëndetin, perkundrazi nga zvoglimi i aktivitetit të përkohëshem që e ka dhënë vite më parë, tani ka rezultuar se është e rritur kjo shkallë e zvogëlimit të aktivitetit prej 27.15%. Andaj, i ka propozuar gjykatës që të detyroje të paditurën që paditësit t'ia paguaj kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, për 50 % të përgjegjësisë, shumën prej 47,232.10 euro, të specifikuar për secilën formë të dëmit veç e veç, si në parashtrësën e dorëzuar për precizimin e kërkesëpadisë, si dhe ka kërkuar që t'i njihet edhe kërkesa aksesore – kamata ligjore si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, të specifikuara si në precizimin e kërkesëpadisë së datës 04.12.2023, duke u mbështetur edhe në arsyet e dhëna për secilen formë të dëmit të kërkuar veç e veç.

I autorizuari i pales se paditur, Sokol Dardha, jurist nga Prishtina, në seancën përgaditore dhe gjatë seancave të shqyrtimit kryesor, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi, dhe e ka kundërshtuar e padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, ngase ka theksuar se nga provat materiale dhe personale vërtetohet se paditësi është vetëaksidentuar, pra dëmi është shkaktuar pa fajin e drejtuesit të automjetit. Andaj, ka deklaruar se nuk është detyrim i të paditurës t'a kompensoj dëmin nga polisa e sigurimit të automjetit nga baza e autopërgjegjësive, duke shtuar se pas pranimit të plotësimit të Super Ekspertizës, u vërtetua se lëshimet primare në aksident janë tani të paditësit, ndërsa lëshimet sekondare ka pasur i siguruari i të paditurës. Pra, ka theksuar se është saktësuar lëshimi i pjesëmarrësve në aksident, duke shtuar se me rastin e vendosjes, gjykata t'a merrë në konsiderat edhe plotësimin e ekspertizës së datës 21.09.2023.

3. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike dhe juridike, në këtë çështje juridike kontestimore në shqyrtimin kryesor i ka administruar këto prova materiale dhe personale: provat materiale, të lexuara paraprakisht në procesverbalin e seances së shqyrtimit kryesor të datës 09.07.2014, certifikata e lindjes L022140408 e datës, 16.09.2008, raporti i aksidentit CR-3004-379-09, i datës 24.08.2009, përpiluar nga Policia e Kosovës, shiqimi - skica e vendit të ngjarjes e datës 24.08.2009, fletëlëshimi i QKUK-së Maksillofaciale dhe orale nr. 279/2009, Fakulteti i Mjeksisë - Klinika e kirurgjisë, deklarata me nr. CR-3004-379/2009, e datës 24.08.2009, deklarata nr. CR-3004-379/2009 e datës, 24.08.2009, deklarata CR.3004-379/2009, e datës 24.08.2009, mendimi dhe konstatimi i dr. Sejdulla Mahmuti, Kirurg, ekspertiza e komunikacionit përpiluar nga eksperti Ismail Berisha me nr. të lëndës P.nr. 46/2009, fletëlëshimi i QKUK-së nr. 74/2009, fotografit nga vend i ngjarjes të datës 24.08.2009, super ekspertiza e komunikacionit e punuar nga instituti i Komunikacionit SH. P. K, prof. dr. Ahmet Geca, udhëzimi i QKSUK-së i datës. 02.09.2010, udhëzimi për specajlistin i datës 02.09.2010, raporti nga konsulta nr. 376, i datës 10.06.2011, mendimi dhe konstatimi i ekspertit të psikiatris Dr. Afrim Cana psikiater, ekspertiza mjekësore kirurgjiko - maksillofaciale punuar nga dr. Sami Salihu, kirurg Maksillofacial, 7 fotografit e paditësit të mitur gjatë trajtimit mjekësor pas aksidentit, plotësimi i ekspertizës mjekësore i kirurgjisë maksillofaciale, i datës 08.12.2021, e hartuar nga eksperti Sami Salihu, super ekspertiza e komunikacionit rrugorë, e punuar nga fakulteti i "Inxhinierisë Mekanike", në UP, e dorëzuar më datë 26.04.2023, plotësimi i super ekspertizës së komunikacionit rrugorë, e punuar nga fakulteti i "Inxhinierisë Mekanike", në Universitetin e Prishtinës, e dorëzuar më datë 21.09.2023, përgjigjja e kërkesës së lëshuar nga Policia e Kosovës, përmes shefit të NJRKDH – Gjilan, e dorëzuar me datë 02.09.2022,

Gjykata, pas analizimit dhe vlerësimit të provave materiale dhe atyre personale dhe vërtetimit të gjendjes faktike, në kuptim të dispozitës së nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se padia dhe kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar në ligj.

Në mes palëve ndërgjyqëse, kontestuese ka qenë se cila prej palëve ka pasur përgjegjësi me rastin e shkakimit të aksidentit të cekur si më lartë, e po ashtu për palën e paditur kontestuese ka qenë edhe lartësia e kërkesëpadisë së paditësit.

Gjykata, lidhur me faktet kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse, është fokusuar që t'i vërtetoj në mënyrë të drejtë dhe objektive, dhe atë përmes këtyre provave materiale dhe personale si në vijim:

3.1 Provat materiale

Në bazë të certifikatës së lindjës L022140408 e datës 16.09.2008, e lëshuar nga Zyra e Gjendjes civile në Kamenicë, gjykata vërtetoi faktin se, L. M. ka lindur më datë, në, nga babai dhe nëna –

Në bazë të raportit të aksidentit CR-3004-379-09, i datës 24.08.2009, perpiluar nga Policia e Kosovës, gjykata vërtetoi faktin se deri te aksidenti kishte ardhë atëher kur nj.A ishte duke lëvizur nga drejtimi i fshati Boston, Komuna e Novobërdës në drejtim të Kamenicës dhe me të arrit në dalje të të fshatit Busavatë, përballë shtëpisë së H. M. me shtyllën e parë të majtë të automjetit gjegjësisht me retrovizorin e majtë e godet Nj.B-këmbësorin L. M.-..... i cili dyshohet se më parë ishte ngjitur në rimorkion e motokultivatorit tip 1964 nga fsh.Busavatë në drejtim të fsh.Boston, dhe me të arritur në vendin kritik gjithnjë sipas raportit të policisë gjatë përballë kalimit të automjeteve dyshohet se fëmiu-këmbësori kërcen nga rimorkio për të zbritur ku edhe ndeshet me nj.A dhe kështu shkaktohet aksidenti ku lëndime trupore pëson këmbësori i cili dërgohet në QKUK.

Në bazë të fletëlëshimit të QKUK-së Maksillofaciale dhe orale nr. 279/2009, Fakulteti i Mjeksis- Klinika e kirurgjis, gjykata vërtetoi faktin se pacienti L. M. është pranuar në Klinikë për shkak të lëndimeve të fytyrës, therjeve të kockave të fytyrës, lëndimeve të dhëmbëve-extraksioneve traumatike të dhëmbëve 11-21 si dhe lëndimeve të indeve të buta në fytyrë-zgavrën e gojës, ku pas konstatimeve rentgenologjike dhe analizave laboratorike me datë 25.08.2009 vendoset që të bëhet intervenimi i nevojshëm kirurgjik me anestezion të përgjithshëm ku gjatë qëndrimit në klinikë pacienti është trajtuar me antibiotic dhe analgjetikë, plaga në buzën e sipërme i është pastruar për çdo ditë, në ditën e shtatë i janë larguar penjtë, kateteri I vendosur në sinisuin e majtë i është lënë për tri javëe, dhe është liruar nga klinika në gjendje të përmirësuar.

Në bazë të mendimit dhe konstatimit të dr. Sejdulla Mahmuti, Kirurg, gjykata vërtetoi faktin se lëndimet e marra si pasojë e aksidentit nga paditësi janë lëndime të rënda trupore përkatësisht ndrydhje koke, dridhje truri, thyerje e kockës së nofullës së poshtme ku të njejtat kanë shkakuar dëmtim të përkohshëm të shëndetit.

Në bazë të fleteleshimit i QKUK-së, Klinikës së Kirurgjisë Maksillofaciale, me numër 74/2009, nga Prof. Dr. Osman Sejfi ja dhe Dr Fisnik Maqedonci, gjykata vërtetoi faktin se L. M., nga Kamenica, i lindur në vitin 2000, është mjekuar nga data 07.04.2010 deri më datën 13.04.2010, me diagnozën “st.post osteosynthesis reg.radicis nasi et infraorbitalis lat.sin”, dhe udhëzimit të përshtuar në të.

Në bazë të fotografive nga vend i ngjarjës të datës. 24.08.2009, gjykata vërtetoi faktin se në rrugen e fshatit Busavatë, Komuna e Kamenicës në drejtim të Novobërdës, janë vendosur shenja për ndalimin e kalimit në pjesën ku ka ndodhur aksidenti, si dhe janë fotografuar kultivatori me rimorkio dhe automjeti VW, me targa 458 – KS – 658, me ngjyre të zezë, me të cilin është shkaktuar aksidenti.

Në bazë të udhëzimit për specialistin, të datës. 02.09.2010, gjykata vërtetoi faktin se L.M. ka qenë në kontrollë sipas udhëzimit për specialistin kirurg maksillofacial nga shërbimi peditarik dhe ka marrë përshkrimin e gjendjes shëndetësore të tij dhe terapinë për rehabilitim sipas Dr.Samir A. Berisha, kirurg maksillofacial.

Në bazë të raportit nga konsulta me numër 367 i datës 10.06.2011, gjykata vërtetoi faktin se, L. M. nga, I lindur më datë, sipas udhëzimit të Spitalit Rajonal në Gjilan, është udhëzuar për kontroll tek Psikiatri, me ç'rastë është kontrolluar tek Dr.Afërdita Mulliqi – Latifi, Psikiatër, në Gjilan, ku i është përshkruar diagnoza PTSD (çrregullim i stresit) dhe janë përshkruar tableta për trajtimin e çrregullimit të pësuar.

Në bazë të mendimit dhe konstatimit të ekspertit të Psikiatrisë Dr. Afrim Cana, e datës 12.03.2014, gjykata vërtetoi faktin se nga aksidenti i shkaktuar, i lartëcekur, L.M., ka pësuar lëndime të rënda, të përshkruara si në ekspertizë, si dhe ka pësuar frikë primare të intensitetit të lartë, për një periudhë prej 10 deri në 15 minuta dhe kjo frikë qenë prezent edhe gjatë kohës së riintervenimit kirurgjik, ndërsa frikë sekondare ka pasur në kohëzgjatje prej 6 muaj. Përveq frikës dhe lëndimeve trupore i njëjti ka pësuar edhe shëmtim funksional estetik shumë transparent me vrraga në regjionin e ballit si dhe mungesa e dhëmbëve 11 – 21 dhe se pasojat psikologjike tek i njëjti shprehen në formë të irritabilitetit, trembje në gjumë.

Në bazë të ekspertizës mjeksore kirurgjiko- maksilofaciale punuar nga Dr. Sami Salihu, kirurg Maksillofacial, gjykata vërtetoi faktin se, L. M. për shkak të lëndimeve të pësuar nga aksidenti i lartëcekur, është pranuar në këtë Klinikën e Kirurgjisë Maksillofaciale, ku janë konstatuar lëndimet si: Thyrje e kompleksit të kockave të hundës dhe nofullës së naltë në të dy anët me zhvendosje të fragmenteve, thyrje të pjesës së përparme të pragut alveolar të nofullës së naltë, nxjerrje traumatike të dhëmbëve incisive endrore në të dy anët (dhembet 11-21), thyrje e nofullës së poshtme në regjionin e mjekrres pa zhvendosje, humbje të mukozes dhe plagë shkyese në buzën e naltë. Të gjitha këto thyrje dhe humbje të dhëmbëve karakterizohen si lëndime të rënda trupore dhe për shkak të këtyre lëndimeve pacienti nënshtrohet dy operacioneve ku behet largimi i pllakave dhe vidave. Pacienti ka pasur dhimbje të intensitetit të lartë në 48 ore e para të lëndimit, ka perjetuar dhimbje të intensitetit mesatar në kohezgjatje prej 3 javëve, pas 3 jave pacienti ka perjetuar dhimbje të intensitetit të lehtë edhe për 3 javët e ardhshme, ndërsa, shëmtimi i pacientit ka shkallë të mesme prej (20%), për shkak të humbjes së dy dhëmbëve të parë dhe pozitës retrognatike të nofullës së naltë dhe të trets së mesme të ftyrës si pasojë e aksidentit. Zvoglimi i përhershëm i aktivitetit jetësor të shkallës së lehtë (10%) për shkak të ç'rregullimit të okluzionit si pasojë e thyrjes së nofullave dhe për pasojë pacienti ka pengesa në përthypjen e ushqimit sepse mungon kontakti normal në mes sipërfaqeve okluzale (përthypse) të dhëmbëve të nofullës së naltë dhe asaj të poshtme, zvoglimi i përhershëm i aftësisë punuese, zvoglimi i përhershëm i aftësisë punuese është në shkallën 10%, sepse pacienti ka

pengesa në përtypjen e ushqimit, rezultat i moskontaktit të mirë të dhëmbëve, si pasojë e mospërtypjes së mirë të ushqimit pacienti nuk e përfundon në menyrë adekuate, pastaj janë shfaqen problemet me lukth siç janë gastritis,ulgera etj. Përkujdesja dhe ndihma e personit të tretë ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 3 javeve në afat 24 ore sepse gjatë kësaj kohe pacienti e ka gojën e mbyllur dhe është i rrezikuar gjatë marrjes së ushqimit apo eventualisht vjelljes, pas këtij afati pacienti ka pas nevojë për përkujdesje 12 oreshe edhe 3 jave tjera për shkak se pacient duhet ushqyer me ushqim të langet dhe duhet përgaditje e veçantë e ushqimit. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 4 muajt e ardhshëm sepse deri në formimin e kallusit dhe mineralizimin e tij për të përballuar forcen e kafshimit. Mjekimi i ardhshëm që pacienti të mos ketë zvoglim të përhershëm të aftesisë punuese dhe zvoglim të përhershëm të aftesisë jetësore pacienti duhet t'i nënshtrohet intervenimit kirurgjik me një kohë trajtimi 6 javorë, trajtimit ortodontik me një kohë trajtimi 6 mujore, dhe trajtimi protetik, vendosja e 2 implanteve për kopmpenzimin e dhëmbëve të humbur, i cili merr 7 muaj kohë deri në rehabilitim e plotë të tij në mënyrë që t'i mundësohet pacientit një kontakt normal i dhëmbëve dhe një pamje estetike të cilën pacienti e kishte para lëndimit. Gjitha këto metoda shërimi marrin kohë 14 muaj e dy javë, dhe se përkunder aplikimit të të gjitha këtyre metodave të shërimit nuk është e sigurt se pacienti do të ketë gjendjen e njëjtë para aksidentit.

Në bazë të plotësimit i ekspertizës mjekesore i kirurgjisë maksilofaciale, i datës 08.12.2021, e hartuar nga eksperti Prof.Dr. Sami Salihu, gjykata vërtetoi faktin se L. M., sipas aksidentit të lartëcekur ka pësuar lëndime të rënda trupore dhe si të tilla janë lëndime deformuese në fytyrë, me pengesa funksionale, estetike-deformuese, pasoja të përtypjes, caniomandibulare që shkallëzohen në shkallë të mesëme sipas tabelës së Balthazarit, të gjitha këto pengesa funksionale dhe pasoja estetike vlerësohen në shkallën prej 27,15%.

Në bazë të super ekspertiza e komunikacionit rrugorë, e punuar nga Prof. Dr. Ahmet Shala, Dr. Arlinda Rrecaj, Dr. Gëzim Hoxha nga fakulteti i "Inxhinierisë Mekanike", në Universitetin e Prishtinës, e dorëzuar më datë 26.04.2023, gjykata vërtetoi faktin se nga aksidenti i lartëcekur lëshimet e këmbësorit kane qenë kalimi i rrugës pa u siguruar se te njëjtin veprim mund ta bëjë pa rrezikuar sigurinë në komunikacion, nga ana e këmbësorit. Kalimi i këmbësorit pas automjetit të ndalur pa u siguruar se një veprim i tillë rrezikon sigurinë në komunikacion. Ndërsa, lëshimet e drejtuesit të automjetit "Passat" kanë qenë, lëvizja me shpejtësi më të lartë se sa shpejtësia e lejuar në vendbanim, 57/50 nga ana e ngasësit dhe pakujdesi gjatë kalimit me automjet në zonë vendbanimi si dhe reagim me vonesë për evitimin e aksidentit nga ana e ngasësit të automjetit "Passat".

Në bazë të plotësimit të Super Ekspertizës së komunikacionit rrugorë, e punuar nga fakulteti i "Inxhinierisë Mekanike", në Universitetin e Prishtinës, e dorëzuar më datë 21.09.2023, gjykata vërtetoi faktin se lëshimet e këmbësorit janë lëshime primare, kalimi i rrugës pa u siguruar së të njëjtin veprim mund ta bëjë pa rrezikuar sigurinë në komunikacion, kalimi i këmbësorit pas automjetit të ndalur pa u siguruar se një veprim i tillë rrezikon sigurinë në komunikacion, ndërsa, lëshimet e drejtuesit të automjetit "..."-janë lëshime sekondare, lëvizje me shpejtësi më të lartë se sa shpejtësia e lejuar në vendbanim, 57/50 nga ana e ngasësit, pakujdesi gjatë

kalimit me automjet në zonë vendbanimi dhe reagim me vonesë për evitimin e aksidentit nga ana e ngasësit të automjetit "Passat".

Në bazë të përgjigjës së kërkesës së lëshuar nga Policia e Kosovës, përmes shefit të NJRKDH – Gjilan, e dorëzuar me datë 02.09.2022, gjykata vërtetoi faktin se se më datë 28.04.2009 rreth orës 16.40 minuta, në fshatin Busavatë ka ndodhur aksident në Komunikacion me lëndime trupore, në aksident janë të përfshira dy njësi automjeti dhe këmbesori i lartëcekur, shikimin e vendit të ngjarjes dhe me tutje, deri në gjykatën përkatëse e ka proceduar hetuesi Xhevat Zejnullahu.

4. Baza juridike

Në bazë të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ligji Nr. 04/L- 077, neni 136 paragrafi 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ligji Nr. 04/L- 077, (LMD-së), është paraparë se *“Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”*. Në bazë të këtij principi pala përgjigjet për dëmin e shkaktuar me dashje dhe nga pakujdesia. Çështja e përgjegjësive subjektive është rregulluar në bazë të nenit 140, të LMD-së. Ndërsa në dispoziten e nenit 169 paragrafi 1, të LMD-së, është paraparë se *“Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi”*, kurse me dispoziten e nenit 174 të po këtij ligji, është paraparë se *“gjykata duke marrë parasysh edhe rrethanat që janë shkaktuar pas shkaktimit të dëmit, do të gjykojë shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues apo mosveprim”*. Në dispozitën e nenit 179 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se *“Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit”*, Neni 172 paragrafi 1 të LMD-së, është paraprë se *“Në rast të vdekjes, të lëndimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit, shpërblimi caktohet, sipas rregullës, në formë të rentës në të holla, për gjithë jetën ose për një kohë të caktuar”*, kurse me dispoziten e nenit 183 paragrafi 1 të LMD-së parashihet se *“Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”*, në dispozitën e nenit 9 dhe 10 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, me numër 04/l-018, ku përcaktohet se *“Sigurimi nga autopërgjegjësia mbulon dëmet në persona dhe pasuri të shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i mjetit motorik”*, *“kompenzimi i dëmit material dhe jomaterial bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve”*, Gjykata vendosi sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi,

Ndërsa duke e u bazuar në dispozitën e nenit 7, të LPK-së, ku përcaktohet se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, si dhe në dispoziten e nenit 319, paragrafi 1, të

LPK-së, ku përcaktohet se “*Secila nga palët ndërgjygjëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta*”, Gjykata vendosi sikurse në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ngase në mungesë të provave materiale relevante, erdhi në përfundim se pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, në shumë prej 35.232.00 euro (tridhjetë e pesëmijë e dyqindë e tridhjetë e dy) euro, shumë kjo përtej shumave të gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e kërkuar në emër të kompenzimit të dëmit material dhe jomaterial, duhet të refuzohet në tërësi si e pabazuar, duke e pasur parasysh faktin se në shkaktimin e aksidentit në trafik, në të cilin aksident ka pësuar lëndime të rënda trupore paditësi, i njëjti ka kontribuar në masë të madhe në shkaktimin e këtij aksidenti, e rrjedhimisht do të ishte e pa drejtë, që të obligohet e paditura, që paditësit t’ia komepensoj edhe këtë shumë të të hollave, të kërkuar në emër të dëmëve materiale dhe jomateriale.

5. Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Duke i marrë parasysh provat materiale të administruara, si dhe dispozitat ligjore të lartëcekura, gjykata ka ardhur në përfundim se paditësi L.M., në aksidentin e trafikut të shkaktuar me datën 24.08.2009, rreth orës 16:40 minuta, në dalje të fshatit Busavatë, Komuna e Kamenicës – Novobërd, ka pësuar lëndime të rënda trupore, për shkak se deri sa drejtuesi i automjetit VW passat, me targa të regjistrimit, A.M., ka qenë duke lëvizur nga drejtimi i fshati Boston, Komuna e Novobërdës, në drejtim të Kamenicës dhe me të arritur në dalje të fshatit Busavatë, Komuna e Kamenicës, përballë shtëpisë së H. M., me shtyllën e parë të majtë të automjetit, gjegjësisht me retrovizorin e majtë e godet këmbësorin tani paditësit L.M., i cili më parë ishte shkëputur nga gjysmo rimorkio e kultivatorit tip 1964, dhe kështu shkaktohet aksidenti ku lëndime të rënda trupore, pëson këmbësori tani paditësit L. M.. Fakte këto të cilat gjykata i ka vërtetuar në bazë të superekspertizës së komunikacionit dhe plotësimit të superekspertizës së komunikacionit të cekura dhe të elaboruara si më lartë, e rrjedhimisht me keto prova materiale është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit.

Në bazë të provave materiale të administruara, respektivisht ekspertizave përkatëse mjekësore të cekura si më lartë, gjykata vlerëson se kërkesa e paditësit për kompenzimin e shumave të kërkuara në emër të të gjitha formave të dëmit material dhe jomaterial, duhet t’i njihet si pjesërisht e bazuar në ligj, me ç’rastë në bazë të këtyre ekspertizave mjekësore gjykata e ka bazuar edhe lartësinë e kërkesëpadisë të paditësit dhe atë:

Në bazë të provave materiale të administruara, Gjykata në emër të dhimbjeve fizike - trupore, e ka aprovuar pjesërisht kërkesën e paditësit L. M., në shumën e cekur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe e vlerësoj si një shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse paditësi sipas konstatimit të ekspertit mjekësor të lartëcekur, si pasojë e lëndimeve të marra ka pësuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë dhe dhimbje fizike të intensitetit të mesëm, të intensiteteve dhe kohëzgjatje të ndryshme, të përshkruara sikurse në ekspertizën mjekësore, e cila është elaboruar si më lartë.

Në emër të frikës së pësuar - përjetuar nga paditësi, gjykata e ka aprovuar pjesërisht kërkesën dhe ka caktuar shpërblimin në shumën e cekur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, të

cilën e ka vlerësuar si shpërblim të drejtë duke u nisur nga fakti se sipas konstatimit të ekspertit mjekësor të psikiatrisë, paditësi ka pësuar frikë primare që ka zgjatur 10 – 15 minuta, dhe që është përcjellë me frikë të madhe, frikë sekondare të intensitetit të lartë rreth 6 muaj, kjo pastaj ka kaluar në frikë sekondare me intensitet mesatar dhe më të ulët.

Në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, gjykata pjesërisht e ka aprovuar kërkesën e palës paditëse dhe e ka caktuar shpërblimin në shumat e cekura si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e vlerësuar si shpërblim të drejtë, ashtu që i'a fali besimin konstatimit të ekspertit mjekësor të lartëcekur edhe në këtë pjesë, duke konsideruar se shumata e lartëcekur, paraqet satisfakcion të drejtë për tejkalimin me më lehtësi të pasojave të kësaj forme të dëmit të shkaktuar.

Në emër të shëmtimit të pësuar nga paditësi, gjykata pjesërisht e ka aprovuar kërkesën e të njëjteve dhe e ka caktuar shpërblimin në shumën e cekur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e vlerësuar si shpërblim të drejtë, duke u nisur nga fakti se nga ekspertiza mjekësore e kirurgjisë - maksilofaciale, është vërtetuar se tek paditësi është prezent shëmtimi trupor në shkallën e përshkruar si në ekspertizën mjekësore.

Duke u bazuar në dispozitat e cekura më lartë si dhe duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit jomaterial, e posaçërisht duke marrë parasysh natyrën dhe shkallën e dëmtimeve trupore të pësuar nga paditësi, moshën e tij, në bazë të vlerësimit të ekspertizave mjekësore të përshkruar si më lartë, gjykata aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, sikurse në vlerat e shpërblimit të dëmit si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimit, duke e vlerësuar si shpërblim real, objektive dhe me bindje se ky shpërblim është në pajtueshmëri me natyrën dhe pasojat e lëndimeve.

Gjykata konsideron se shumata e gjykuara si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, paraqesin një satisfaksion moral dhe shpagim real për format e dëmeve, respektivisht lëndimeve dhe pasojave të pësuar nga paditësi në aksidentin e komunikacionit të datës 24.08.2009, të cekur si më lartë, duke marrë parasysh edhe kriteret e parapara me dispozitën e nenit 200, të Ligjit mbi Marrdhëniet e Detyrimeve, standardin jetësor të qytetarëve të Kosovës dhe praktikën e deri tanishme të gjykatave të Kosovës.

Lidhur me shumën e gjykuar për paditësin që ka të bëjnë me kompenzimin e dëmit material në emër të ndihmës dhe përkujdesjes nga personi i tretë në shumat e cekura si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e aprovojë në tërësi kërkesën e palës paditëse dhe atë duke e pasur parasysh konstatimin e ekspertit mjekësor të lartëcekur, të cilët kanë konstatuar se paditësi ka pasur nevojë për ndihmë dhe përkujdesje nga personi i tretë dhe atë për ndihmë për veshëmbathje, higjienë, ushqim dhe aktivitete tjera, ndërsa lidhur me shumat e gjykuar në emër të ushqimit të përforcuar në shumat e cekura si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi gjykata e aprovojë në tërësi kërkesën e palës paditëse dhe atë duke u bazuar poashtu në konstatimin e lartëcekur të ekspertit mjekësor, i cili ka konstatuar se për paditësin ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm, ashtu që shumata e gjykuara i vlerësojë si të pranueshme si për nga baza, poashtu edhe për nga lartësia e kërkuar nga ana e këtij paditësit. Andaj, Gjykata i ka aprovuar në tërësi kërkesat sa i përket dëmeve të këtij lloji. Gjykata ka vendosur sikurse në

pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi sa i përket dëmit material të këtij lloji, të pësuar nga paditësi, duke marr për bazë praktikën gjyqësore në Republikën e Kosovës. Gjykata e ka marr për bazë kohëzgjatjen e nevojës për ndihmë dhe përkujdesje nga personi i tretë dhe ushqimin e përforcuar të konstatuar në ekspertizë mjekësore të ortopedisë dhe traumatologjisë të cekur si më lartë për paditësit, si dhe nga fakti që praktika gjyqësore i njeh rastet e tilla të kompensimit. Në këtë drejtim, duhet të merret parasysh fakti se për këto forma të dëmit në shumicën dërmuese të rasteve palët e kanë të pamundur apo shumë të vështirë të sigurojnë dëshmi konkrete, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm, është vështirë të argumentohet me prova konkrete. Mirëpo, pasi që paditësi ka pasur nevojë për ndihmën e huaj dhe ushqim të përforcuar (të cekur sikurse në ekspertizën e cekur më lartë), të njëjtit ligjërisht i takon ky lloj i kompenzimit të dëmit i kërkuar në shumat e gjykuara.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ku pas vlerësimit të të gjitha provave të administruara dhe fakteve të vërtetuara, gjykatës i rezultoi se kërkesëpadia e paditësit përtej shumave të aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi është kërkesë e pabazë, pasi që gjykata në bazë të superekspertizës të punuar nga fakulteti i “Inxhinierisë Mekanike”, në Universitetin e Prishtinës, të datës 21.09.2023, vërtetoi faktin se lëshimet e këmbësorit, tani paditësit L. M., janë lëshime primare, me rastin e shkaktimit të aksidentit të trafikut, të shkaktuar me datën 24.08.2009, rreth orës 16:40 minuta, në dalje të fshatit Busavatë, Komuna e Kamenicës – Novobërd. Gjykata po ashtu, ka konstatuar se lëndimet e këtu paditësit janë lëndime të rënda trupore por, që shumat e aprovuara në emër të kompenzimit, janë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë së paditësit, me rastin e shkaktimit të aksidentit të cekur si më lartë. Duke i marrë parasysh këto gjykata e ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësve në lidhje me dëmet jomateriale dhe materiale në lartësit e cekura si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, shuma këto përtej shumave të gjykuara si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi sepse nuk gjeti bazë ligjore e materiale për mbështetje edhe për këtë pjesë të kërkesës së palës paditëse, pasi që caktimi i shumave më të larta nuk do të ishte në proporcion me përgjegjësit e palëve ndërgjyqëse me rastin e shkaktimit të aksidentit të trafikut të cekur si më lartë, pasi që përgjegjësia e palës së paditur në rastin konkret ka qenë përgjegjësi sekondare, me lëshimet e elaboruar si më lartë.

Gjykata, duke u bazuar në supereksptertizën e komunikacionit e posaqërisht në plotësimin e supereksptertizës së komunikacionit, të punuar nga fakulteti i “Inxhinierisë Mekanike”, në Universitetin e Prishtinës, të datës 21.09.2023, mbi bazën e të cilave ekspertiza, pa mëdyshje u vërtetua se përgjegjësia e shkaktimit të aksidentit të trafikut në rastin konkret, nuk ka qenë përgjegjësi e barabartë apo 50% me 50%, përkundrazi është vërtetuar se lëshime primare të cilat kanë ndikuar në shkaktimin e aksidentit, kanë qenë lëshimet e këmbësorit tani paditësit L.M., mirëpo në shkaktimin e aksidentit të trafikut të lartëcekur, me lëshime sekondare ka kontribuar edhe i siguruari i të paditurës, e rrjedhimisht gjykata duke u bazuar në praktiken gjyqësore, ka vendosur që përgjegjësinë për dëmet e shkaktuara në aksidentin e trafikut të cekur si më lartë, ta ndajë në 70% për këmbësorin tani paditësin dhe 30% për të siguarin e të paditurës, e mbi këtë bazë gjykata ka vendosur që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, t’u aprovoj si pjesërisht të bazuar sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata i ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të administruara në shqyrtimin kryesor por, erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike kontestimore.

Meqenëse e paditura, ka rënë në vonesë lidhur me pagesën e dëmit të krijuar, e duke u bazuar në nenin 382 paragrafi 2 të LMD-së, gjykata e obligojë të paditoren, që paditësit t'ia paguajë shumat e gjykuara të kompenzimit sëbashku me normën e kamatës, në lartësi prej 8 %, duke filluar nga data e marrjes se aktgjykimit të parë, të datës 12.08.2011, në afat prej 15 ditësh, pas datës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

6. Shpenzimet e procedurës kontestimore

Gjykata, lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore vendosi duke u mbështetur në nenin 449 dhe 452 paragrafi 1 të LPK-së, si dhe në bazë të tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës, dhe e detyroi të paditurën, që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë për këto veprimë procedurale: në emër të përpilimit të padisë shumë prej 208,00 €uro, në emër të përfaqësimeve për 5 (pesë) seancave të mbajtura në gjykimin e parë dhe rigjykimin e dytë, ku kontesti për këtë çështje juridike është mbi 10.000,00 euro, në shumë prej 1.352,00 euro, në emër të përfaqësimeve për 10 (dhjetë) seancave të mbajtura gjyqësore në rigjykimin e tretë, ku kontesti për këtë çështje juridike është mbi 10.000,00 euro, shumë prej 2.704,00 euro, në emër të pagesës së ekspertizës së komunikacionit rrugor, të dt. 28.10.2013, të punuar nga Instituti i Komunikacionit, përmes Prof. Dr. Ahmet Geca, shumë prej 450.00 euro, në emër të pagesës së ekspertizës së komunikacionit rrugor, të dt. 13.01.2020, të punuar nga grupi i ekspertëve Visar Baxhuku, Bajram Latifi dhe Rrahim Sopjani, shumë prej 450.00 euro, në emër të pagesës së ekspertëve mjekësore, shumë prej 450.00 euro, në emër të përpilimit të ankesës së dt. 24.09.2011, ndaj aktgjykimit C.nr. 174/09 i dt. 12.08.2011, shumë prej 416.00 euro, në emër të pagesës së taksës gjyqësore për ankesën e dt. 24.09.2011, shumë prej 25.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore për padi, shumë prej 100.00 euro.

Duke u bazuar në thëniet dhe dispozitat materiale të lartëcekura, si dhe në dispozitën e nenit 143 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË KAMENICË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C. nr. 79/2019, i datës 02.05.2024

Numri i lëndës: 2019:271631
Datë: 07.05.2024
Numri i dokumentit: 05656633

G j y q t a r i
Artan Abazi, d. v

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.